



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.208/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Kryesuesi kryesuese, Fejzullah Rexhepi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi duke vendosur përkitazi me ankesën e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mos ndërmarrjes së veprimit për largimin e materialit promovues, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 05.10.2019, mori këtë:

### VE N D I M

**Refuzohet** e pabazuar ankesa Anr.208/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë.

### A r s y e t i m

Me datën 03.10.2019, Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 03 Tetor 2019, rreth orës 15:00, Fushë Kosovë, rreth 10 metra larg shkollës fillore Mihail Grameno, gjendet akoma bilbordi i kandidatës për kryeministre Vjosa Osmani, edhe përkundër faktit se për të njëjtin bilbord është gjobitur nga PZAP-i, me vendimin e datës 27 Shtator 2019, me numër Anr.99/2019, subjekti në fjalë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për largimin e atij materiali promovues, edhe pse është vendosur mbi rrugë, në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuar.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2019, subjekti politik LDK, e kundërshton në tersi ankesën e parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, ngase bilbordi i kandidatës për kryeministre znj.Vjosa Osmani, është larguar nga ajo hapësirë, gjegjësisht te mbi kalimi në Fushë Kosovë afër SHFMU “ Mihail Grameno”, edhe përkundër faktit se ka pas një vendim të autoritetit komunal, të cilën PZAP-i, e as Gjykata Supreme nuk e ka vlerësuar si provë, dhe në këtë rast LDK, ka ndërmarrë masa përmirësuese duke larguar bilbordin e vendosur në mbikalimin.

Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur, një fotografi të printuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

## **Ankesa është e pabazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë në përgjigje në ankesë, shihet qartë se bilbordi i kandidates për kryeministre të LDK-së, e cila ka qenë e vendosur në mbikalim, afër shkollës “Mihail Grameno” në Fushë Kosovë, është evituar shkelja dhe kjo dëshmohet me fotografinë e bashkangjitur në përgjigje.

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së. Në rastin konkret subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë, ka arritur të dëshmojë me fakte - fotografitë e ofruara, se ka ndërmarrë masa përmirësuese në kuptim të nenit në kuptim të nenit 120.1, pika a).

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe IKS, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse të përcaktuar në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk rezulton se në këtë rast se ka ndodhur shkelje e dispozitave ligjore të LZP-së, e as rregulloreve të KQZ-së, dhe për rrjedhojë nuk ka bazë ligjore që ndaj subjektit politik LDK, të shqiptohet gjobë në kuptim 120 par 1 pika c) të LZP-së,

Paneli gjatë vendosjes i vlerësoi edhe provat e bashkangjitura në ankesë, mirëpo këto prova nuk patën ndikim në vendosjen ndryshe të çështjes, pasi që nga fotografitë e ofruara në ankesë, nuk shihet data se kur është bërë fotografimi, dhe nuk ka dëshmi të qarta dhe bindëse, se kjo fotografi, korrespondon me datën e kryerjes se shkeljes siç pohohet në ankesë.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të nenit 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.208/2019 më datën 05.10.2019



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.